

Zhvillohet protestë në Gaza në shenjë solidariteti për të burgosurit palestinezë në burgjet izraelite, raporton Anadolu Agency (AA).

Familjet palestineze u mblodhën para ndërtesës së Kryqit të Kuq në Gaza dhe kërkuan nga organizatat për të drejtat e njeriut që të ndërmarrin hapat e nevojshëm për lirim të të gjithë palestinezëve në burgjet izraelite. Protestuesit mbajtën në duar fotografitë e të afërmeve të tyre.

Selva el-Xhuxhu (Selva el-Cucu), nëna e të burgosurit palestinez Xhuma el-Xhuxhu (Cuma el-Cucu) duke vënë në dukje se të burgosurit janë në kushte të vështira tha: "Të burgosurit, vuajnë nga shumë sëmundje, gjithashtu kushtet në burg nuk janë të përshtatshme për kurimin e tyre. Ne kërkojmë nga Presidenti palestinez Mahmud Abbas që të ushtrojë presion ndaj institucioneve ndërkombëtare për lirim të të burgosurve.

Nga ana tjetër Izraeli ka njoftuar se ka anuluar "ditën e takimit" të organizatës së Kryqit të Kuq që ishte planifikuar për të burgosurit palestinezë në burgjet izraelite. Sipas të dhënave nga Ministria palestineze e të Burgosurve, në burgjet izraelite ndodhen 7 mijë palestinezë të burgosur.